



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja **b**, neni 40, shkronja **I** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 dhe nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, Udhëzimit administrativ nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor, nenit 15, paragrafi 15.1. shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021, merr këtë

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN TE  
FAKULTETI TEKNIK, NË LAGJEN "BREGU I DIELLIT", 2019-2027**

**Neni 1**

**Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor**

**MIRATOHET** Vendimi i Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit", 2019 – 2027.

**Neni 2**

**Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor**

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

**Neni 3**

**Qëllimi i hartimit**

Me miratimin e Planit rregullues të hollësishëm, nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale, me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

**Neni 4**

**Kufiri i territorit**

Territori që përfshihet nga Plani rregullues i hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit", 2019 – 2027, gjendet në lagjen "Bregu i Diellit" dhe përfshinë sipërfaqen prej  $S = 9.08$  Ha. Rrugët që e kufizojnë këtë plan janë: rruga "Fadil Vata", në pjesën veriore, rruga "Arbënor e Astrit Dehari", në pjesën jugore, rruga "Xhevë Lladrovci", në perëndim, dhe rruga "Nezir Gashi", në lindje.

Parcelat që shtrihen brenda kufirit të hapësirës që trajtohet janë:

ZK, Prishtinë: 2735-1, 2734-0, 2726-0, 2725-0, 2724-0, 2723-0, 2722-0, 2720-0, 2730-0 (pjesërisht).

Parcelat ku shtrihet ky plan janë në pronësi private dhe komunale, dhe gjenden në Zonën kadastale, Prishtinë.

#### **Neni 5** **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm**

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili ka bërë hartimin e Planit rregullues të hollësishëm.

#### **Neni 6** **Afati i vlefshmërisë**

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë 8-vjeçare.

#### **Neni 7** **Gjuha zyrtare**

Plani rregullues i hollësishëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

#### **Neni 8** **Programi**

Pjese e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor.

#### **Neni 9** **Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-350/05-185476/21, më 03.09.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

